



Organizata për Siguri dhe
Bashkëpunim në Evropë
Prezenca në Shqipëri

INTERVISTË E KRYETARIT TË PREZENCËS SË OSBE-SË NË SHQIPËRI, AMBASADORIT BERND BORCHARDT, ME GAZETËN “PANORAMA”

18 nëntor 2019

Intervistoi: Mariglen Kume

Pak kohë më parë, OSBE-ja, në bashkëpunim me komisionin parlamentar, zhvilluan një tryezë diskutimi për çështjet e reformës zgjedhore. Aty ishte e pranishme edhe opozita. Pas kësaj, të dyja palët kanë vazhduar punën të ndara. Ende nuk kemi një dialog. A ka OSBE-ja një plan që t'i ulë palët bashkë?

Opozita - tashmë jashtëparlamentare - ka kontribuar vërtet në këtë reformë thelbësore deri në fund të vitit të kaluar, në kuadrin e Komisionit të Posaçëm Parlamentar. Një kontribut i lavdërueshëm, duhet të them. Është për të ardhur keq që ky kontribut u ndërpre kur PD-ja dhe LSI-ja u tërhoqën masivisht nga Kuvendi, në shkurt të këtij viti. Që nga ajo kohë, në shumë raste, OSBE-ja ka ftuar të gjitha palët të ulen së bashku dhe të diskutojnë rreth kësaj reforme vendimtare. Sekretari i Përgjithshëm i OSBE-së, Thomas Greminger, e përsëriti këtë mesazh edhe kur u takua me drejtuesit e opozitës muajin e kaluar, gjatë ditëve të Konferencës Mesdhetare të OSBE-së, konkretisht duke u kërkuar atyre që të marrin pjesë në seminarin tonë teknik për financimin e partive politike, më 19 nëntor, të cilin e organizojmë së bashku me Këshillin e Evropës dhe Institutin Demokratik Amerikan (NDI). Por, siç e theksoi me të drejtë Sekretari i Përgjithshëm Greminger me atë rast, OSBE-ja nuk mund të detyrojë asnjë parti politike të angazhohet në dialog me partitë e tjera për proceset thelbësore të reformës, kundër vullnetit të saj. Ne vijojmë të ftojme opozitën jashtëparlamentare të marrë pjesë në të gjitha veprimtaritë që organizojmë për të ndihmuar reformën zgjedhore. Shfrytëzoj këtë rast për të përshëndetur vendimin e Partisë Demokratike për të dërguar ekspertin e saj në konferencën për reformën zgjedhore, që organizuam, në shtator, me të gjitha partitë politike në vend. Shpresoj që ata të vijojnë të përfshihen në këto veprimtari me karakter ndihmues.

U keni kërkuar ju një afat kohor partive politike në Shqipëri se kur duhet të përfundojnë draftimin e propozimeve të tyre të reformës zgjedhore?

Prezenca nuk u vendos afate subjekteve politike, nuk e kemi këtë tagër. Ashtu si pjesa tjetër e bashkësisë ndërkombëtare, ne kemi theksuar, në mënyrë të përsëritur, se reforma duhet të përfundohet sa më shpejt që të jetë e mundur dhe që është me rëndësi jetësore zbatimi i të gjitha rekomandimeve të OSBE/ODIHR-it, që kanë mbetur të pazbatuara pas çdo cikli zgjedhor që ka kryer vendi. Të mos harrojmë se kjo reformë është për të mirën e vendit dhe qytetarëve të tij, jo për të mirën e bashkësisë ndërkombëtare. Është kushti i vetëm ndër kushtet për hapjen e negociatave për pranimin në BE që kërkon një “po” ose “jo”, çka do të thotë që, nëse nuk bëhet, dëmtohen shanset e Shqipërisë për hapjen e negociatave. Por ky nuk është qëllimi ynë, ai duhet të jetë qëllimi i politikanëve tuaj të të gjitha partive politike, që mund të sjellin ndryshimin përmes propozimeve kuptimplota dhe thelbësore. Qëllimi ynë është të mbështesim procesin

me ekspertizë teknike dhe të lehtësojmë dialogun. Nuk e drejtojmë ne procesin, ne e mbështesim atë, në përputhje me mandatin tonë. Partitë politike shqiptare janë, apo duhet të jenë, ato që e çojnë përpara këtë proces thelbësor.

Kryeministri Edi Rama, por edhe eksponentë të tjerë të maxhorancës, pasi nuk kanë arritur një dakordësi me opozitën, kanë deklaruar se do ta miratojnë (do ta bëjnë reformën) me deputetët e rinj, të cilët erdhën në parlament pasi PD-ja, LSI-ja dhe aleatët e tjerë dogjën mandatet. A do njihej kjo reformë nga ana e OSBE-së dhe sa e plotë do të ishte kjo reformë?

Duhet të theksoj, edhe një herë, që OSBE-ja nuk ka tagër të "njohë" nismat e rëndësishme legislative të shteteve të saj pjesëmarrëse. Maksimumi që mund të bëjmë, pasi një shtet pjesëmarrës sovran miraton një ligj në parlamentin e vet, është të themi nëse ai ligj është në përputhje me standardet ndërkombëtare. Është e drejta e kombeve sovraane të miratojnë ligjet e tyre me nismën e politikëbërësve që kanë synim mirëqenien e qytetarëve të tyre. Kjo e drejtë nuk mund të cenohet. Nëse ndryshimet në ligjin zgjedhor do të pasqyronin rekomandimet e OSBE/ODIHR-it, kjo do ta bënte atë vërtet më të mirë sesa ligji ekzistues.

Si do të ndikonte një veprim i tillë në klimën politike, a do ta përkeqësonte klimën?

Reforma do ta sillte administrimin e zgjedhjeve në nivelin e standardeve demokratike dhe, me siguri, do ta përmirësonte klimën politike, duke eliminuar shkaqet e pretendimeve për manipulim të zgjedhjeve, keqadministrim të tyre, përdorim abuziv të mediave, mospërfaqësim të grave në zgjedhje, etj.. Prezenca e OSBE-së u ofroi të gjitha palëve politike mundësinë që të kontribuojnë në këtë proces, duke organizuar konferenca dhe tryeza pune, ku ata mund të hidhnin në tryezë propozimet e tyre. Për më tepër, opozita jashtëparlamentare ka një vend të rezervuar në Komisionin e posaçëm, me të njëjtën të drejtë vetoje si bashkëkryetarët e Komisionit; kjo është një hapësirë e rëndësishme, ku mund të kontribuohet dhe që, deri tani, nuk është përdorur. Unë besoj se ka akoma kohë që legjislacioni zgjedhor të reformohet, me kontributin e të gjitha partive politike, të marrë miratimin përfundimtar të palëve dhe ta çojë vendin përpara, jo ta përkeqësojë klimën politike. Askush nuk duhet të humbasë mundësinë që zëri i vet të dëgjohet. Ne jemi më se të gatshëm të lehtësojmë dialogun, në formate fleksibile të pranuar nga të gjitha palët. Ekspertizën tonë ne gjithmonë do ta përdorim për të mbështetur një dialog të tillë.

Maxhoranca publikoi, pak kohë më parë, një paketë të reformës zgjedhore. Sa ishin reflektuar rekomandimet e OSBE/ODHIR në atë draft?

Disa janë reflektuar, disa jo. Kjo është arsyeja që puna vijon derisa ato rekomandime të pasqyrohen më saktë në projektligjin përfundimtar, që do të votohet në Kuvend. Ne e përshëndesim vazhdimin e këtyre përpjekjeve të rëndësishme dhe do të vijojmë t'i mbështesim ato, në përputhje me mandatin tonë.

Ndërsa ekspertët e komisionit parlamentare bënë publike një memo për shkrirjen e KQZ-së, dhe depolitizimin e administratës zgjedhore. Jeni njohur ju me të, si e vlerësoni?

Me të drejtë thatë një "memo", një mendim ekspertësh, një propozim i bërë nga ekspertët. Në momentin kur ky mendim i ekspertëve të diskutohet dhe të planifikohet për debat dhe votim,

sipas rregullores së debatit parlamentar, ka shumë të ngjarë që ODIHR-i të shprehë një mendim. OSBE/ODIHR-i është institucioni i mandatuar i OSBE-së, që trajton çështjet e reformës zgjedhore, përmes analizave të legjislacionit dhe dhënies së rekomandimeve. Roli i Prezencës së OSBE-së këtu, siç përcaktohet në mandatin tonë, është të monitorojmë dhe të raportojmë për procesin e zhvillimit të ligjit në fjalë.

Nga opozita, kryedemokrati Basha por edhe nga maxhoranca artikulojnë shpesh se ligji aktual zgjedhor është i mirë dhe nëse ka vullnet politik mund të prodhojë zgjedhje me standarde. Ndani edhe ju të njëjtin qëndrim?

Këto janë nuanca të rëndësishme. Do të përpiqem t'i bëj ato më të qarta. Shqipëria ka mbajtur zgjedhje të njohura ndërkombëtarisht, për shumë vite tashmë, bazuar në ligjin ekzistues, kjo është e vërtetë. Por zgjedhjet janë përbaltur nga akuzat për manipulim, keqpërdorim i mediave, përfaqësim i ulët i grave, mungesë e mundësive për diasporën për të votuar, etj.. Çështja këtu është: A dëshiron Shqipëria të përmirësojë legjislacionin zgjedhor, që ka sjellë gjithë këto pasoja negative, pas çdo cikli zgjedhor, apo do të vijojë të marrë vlerësime negative për administrimin e zgjedhjeve? Ky opsion i fundit qartësisht nuk është i dëshirueshëm për një vend që do të mbajë kryesinë e OSBE-së vitin e ardhshëm dhe aspiron një status më të lartë në bashkësinë ndërkombëtare, përfshirë hapjen e negociatave të pranimit me Bashkimin Evropian. Pra, nuk ka rëndësi që legjislacioni aktual mundëson organizimin e zgjedhjeve të njohura ndërkombëtarisht, për sa kohë që krijon hapësirë për vërejtje e kritika, të cilat i gjeni në raportet e OSBE/ODIHR-it për zgjedhjet, që nga viti 2013. Unë nuk mendoj se Shqipëria mund të vijojë kështu dhe legjislacioni zgjedhor duhet të reformohet shpejt dhe në tërësi. Gjërat po shkojnë në drejtimin e duhur.

Z. Borchardt, deri tani kemi dy kryetarë bashkish të dalë nga zgjedhjet e 30 qershorit, të cilët, njëri dha dorëheqjen para se të betohej dhe tjetri u shkarkua nga KQZ-ja; po ashtu kemi edhe një tjetër që ka akuza se është subjekt i dekriminalizimit. Pas këtyre ndodhive, sipas jush a e kanë më legjitimitetin zgjedhjet e 30 qershorit?

Vetëm Gjykata Kushtetuese mund të japë një gjykim normativ mbi ligjshmërinë dhe kushtetutshmërinë e zgjedhjeve të 30 qershorit, pasi të jetë krijuar dhe të fillojë nga puna, gjë që ne shpresojmë të ndodhë shpejt. Çështja e kryetarëve problematikë të bashkive është një çështje e rëndësishme, pasi të tre dyshohej se kishin shkelur ligjin e dekriminalizimit. Në rastet kur këto akuza u vërtetuan, kryetarëve iu hoq mandati dhe dhënë dorëheqjen. Unë i përgëzoj institucionet për reagimet e shpejta, sepse ato kanë bërë punën e tyre në mënyrën e duhur, kur ka dyshime për shkelje të tilla ligjore. Pasojat politike të këtyre tri rasteve mund të jenë shqetësim për Partisë Socialiste, por siç kam parë kohët e fundit, partia që i propozoi ata është e vetëdijshme për veprimet që duhet të ndërmerret për të korrigjuar situatën dhe për të shmangur dukuri të tilla në të ardhmen.

Si mund të ndërhyhet në Kodin Zgjedhor për të shmangur ato që kanë ndodhur me dy kryetarët e bashkive që nuk janë më tani?

Kodi Zgjedhor rregullon organizimin administrativ të zgjedhjeve, duke përfshirë çështje përkatëse nga ana demokratike si pjesëmarrja e barabartë, mbulimi i medias, apo çështje përkatëse nga ana ligjore si ndodhi të paligjshme gjatë procesit zgjedhor; për shembull, blerja

e votës apo votimi familjar. Nga këndvështrimi i këtyre kryetarëve, të cilët tashmë janë nën akuzë për mostregimin e gabimeve të tyre të pretenduara në të kaluarën, ligji i dekriminalizimit ofron mjetet juridike. Është një ligj i mirë dhe duhet përkrahur në mënyrë më sistematike, përpos kontroleve të brendshme partiake të përmirësuara. Vetë partitë politike duhet të sigurohen që për kandidatët e tyre nuk ka asnjë hije dyshimi për përfshirje në veprimtari kriminale, duke i detyruar ata të japin informacion rreth së kaluarës së tyre. Nëse partitë nuk respektojnë këtë detyrim politik ndaj zgjedhësve, atëherë ligji hyn në veprim. Më duhet të përgëzoj faktin se është zbuluar se këta kryetarë bashkish të sapozgjedhur mund të ishin në shkelje të ligjit të dekriminalizimit. Kjo është tashmë një arritje e rëndësishme dhe ata duhet të përballen me pasojat, nëse kanë shkelur ligjin. Jam i sigurt se zbatimi i ligjit do të vendosë një shembull të rëndësishëm, në mënyrë që, në të ardhmen, partitë dhe kandidatët të mos përfundojnë në të njëjtën mënyrë.

Z. Ambasador, si është bashkëpunimi i Prezencës së OSBE-së me Partinë Demokratike dhe aleatët e saj?

Prezenca e OSBE-së punon njësoj me të gjitha institucionet dhe të gjithë aktorët politikë, sipas mandatit tonë. Jemi takuar disa herë për të diskutuar çështje të rëndësishme si reforma zgjedhore, i kemi ftuar gjithmonë të marrin pjesë në veprimtaritë dhe projektet tona, njësoj si çdo aktor tjetër politik. Ne mendojmë se Prezenca ka bashkëpunuar me Partinë Demokratike dhe aleatët e saj në mënyrë të hapur dhe të barabartë, si me çdo parti tjetër politike. Dialogu me të gjithë është një tipar dallues i OSBE-së.

Eksponentë të rëndësishëm në PD, shpeshherë, kanë thënë se janë të pakënaqur me punën tuaj në Shqipëri. Ata thonë se ju keni mbajtur anën e njëjës palë. Sa e vërtetë është, përse është kjo "përplasje" e PD-së me ju?

Unë, personalisht, nuk e shoh veten në "përplasje" me ata. Sinqerisht, më vjen keq për këtë perceptim, nëse është realisht i vërtetë. Ndoshta duhet t'i pyesni ata nëse ju thoni se janë ata të cilët ankohen për mua. Më duhet të përsëris përgjigjen time të mëparshme: ne, si organizatë dhe unë, si Kryetar i Prezencës, i kemi ftuar haptazi të gjitha partitë të marrin pjesë në veprimtaritë tona, për të dialoguar, në mënyrë që ne të mund t'i trajtojmë më mirë problemet e vendit, në momentin që këto probleme identifikohen nga ata. Në këtë drejtim, dera jonë ka qenë dhe mbetet e hapur.

Keni mbajtur ju qëndrime pro maxhorancës në deklaratat tuaja?

Prezenca e OSBE-së në Shqipëri ka qenë gjithnjë në favor të procesit demokratik, shtetit të së drejtës, institucionalizimit dhe rendit publik. Puna jonë nuk ka të bëjë me partitë apo individët, por me institucionet dhe ligjshmërinë. Ne reagojmë, në përputhje me mandatin tonë, kur cenohet procesi demokratik, kur priset rendi publik përmes akteve të dhunshme, dhe kur procesi institucional del nga binarët drejt qasjeve jashtinstitucionale. Këto nuk janë të pranueshme dhe është detyrimi i Prezencës tonë të reagojë, sipas mandatit tonë dhe rolit tonë këtu. Ne nuk kemi përgëzuar asnjëherë maxhorancën në pushtet, ashtu siç nuk kemi fajësuar asnjëherë opozitën. Ky pretendim favorizimi është thjesht interpretim politik i njëanshëm, i bazuar në interesa politikë.

Z. Ambasador, ju keni pasur edhe një incident me disa banorë protestues. Pas atij gjesti, ata kanë kërkuar largimin tuaj nga posti që mbani. I keni marrë ndonjëherë në konsideratë thirrjet e tyre?

Faleminderit për këtë pyetje. Më jep mundësinë të nxjerr në pah disa elemente të rëndësishme. Kisha dalë për shëtitje me bashkëshorten time atë mbrëmje, pa qenë në dijeni se po zhvillohej një protestë përpara Drejtorisë së Policisë, aq më pak të dija se për çfarë po bëhej protesta. Papritmas, na u afruan disa burra, njerëzit bërtisnin duke na sharë dhe silleshin në mënyrë agresive. Më duhet ta theksoj, ishin burra, jo gra apo fëmijë, siç po pretendojnë disa media tani. Kjo na gjeti tërësisht të papërgatitur mua dhe bashkëshorten time dhe ajo, me të drejtë, u frikësua. Nëse e shihni fytyrën e saj të tmerruar, në videon e shpërndarë gjerësisht, atëherë e kuptoni se çfarë ndodhi. Nuk e kuptuam se çfarë po ndodhte, u ndiem të kërcënuar drejtpërsëdrejti dhe u çorientuam. Mendova se ishin të njëjtët dhunues që na terrorizuan në apartamentin tonë, në katin e 12-të, në mesnatë, në maj të vitit 2019, dhe e humba kontrollin emocional për pak sekonda. U pendova dhe kërkova ndjesë menjëherë, duke kuptuar që mund të kem fyer njerëz të tjerë, ata të cilët po protestonin përballë zyrave të Policisë dhe për ankesat e të cilëve nuk kisha dijeni. Ende më vjen keq dhe ende i qëndroj ndjesës publike që kam bërë. E shikoj tani se si disa media e vendosin këtë incident në rrotullën politike. Ky keqinterpretim bëhet me keqbesim dhe është i motivuar politikisht.

Për të kaluar në një temë tjetër. Parlamenti i është rikthyer sërish debatit për ligjin antishpifje. A i duhet vendit tonë një ligj i tillë?

Ne shohim një stuhi mediash, shumë të ashtuquajtura faqe interneti gazetareske, të cilat shpërndajnë thashetheme, shpifje dhe informacion të njëanshëm politikisht. Liria e shprehjes nuk do të thotë që kushdo mund të thotë ç'të dojë për çdo njeri. Figurat publike nga të gjitha fushat e jetës, jo vetëm nga politika, përballen me deklarata shpifëse, akuza të pabaza, sulme personale kundër tyre dhe familjarëve të tyre. Besimi i publikut te jeta publike dëmtohet. Lexuesit dhe shikuesit do të shkëputen përfundimisht, nëse u ekspozohen praktikave të tilla. A është e drejtë kjo? Nëse jo, si duhet ta zgjidhë Shqipëria këtë problem serioz? Dënimi penal duhet të eliminohet, zgjidhja e gjykatës civile është e parapëlqyer dhe akoma më i parapëlqyer është vetërregullimi i mediave. Por si zhvendoset kjo në praktikë?

Qeveria doli me propozime konkrete, të cilat, sipas Përfaqësuesit të OSBE-së për Lirinë e Medias, nuk ishin në linjë me standardet ndërkombëtare. Ekspertët e Zyrës së tij po punojnë me Qeverinë për t'i përmirësuar këto propozime legjislative. Jam i sigurt që rezultati i përpjekjes së tyre të përbashkët do të jetë në linjë me standardet ndërkombëtare, nëse Qeveria i pranon plotësisht këshillat dhe ekspertizën e vënë në dispozicion nga ky institucion i rëndësishëm i OSBE-së. Shqipëria do të ketë Kryesinë e OSBE-së vitin e ardhshëm. Një ligj i mirë mund të bëhet një model për të gjithë rajonin dhe më gjerë, si edhe një sukses i madh për Kryesinë e Shqipërisë.

Prezenca e OSBE-së në Shqipëri e ka përkrahur dhe promovuar prej shumë vitesh vetërregullimin si një alternativë e rregullimit nga qeveria. A ka bërë ndonjë gjë media shqiptare për t'u vetërregulluar? Me sa më kanë informuar kolegët e mi, ka një organ të quajtur Këshilli i Medias, i cili bën përpjekje për të përkrahur vetërregullimin, një Kod Etike të Medias, por pa shumë progres, të paktën jo të njohur publikisht. Për më tepër, kolegët e mi në Prezencë

më kanë informuar se, disa vjet më parë, u krijua një shoqatë vetërregulluese, me mbështetjen e Prezencës sonë dhe me financim të BE-së. Quhej Klubi Shqiptar i Medias. Ai u përshtat duke përdorur një model të ngjashëm vetërregullues në Rumani. U krijua me mbështetjen e ekspertëve nga Gjermania, Mbretëria e Bashkuar, Belgjika dhe Holanda. Fatkeqësisht, përbëhej vetëm nga media lokale. Mediat e rëndësishme, me bazë në Tiranë, refuzuan t'i bashkoheshin, pavarësisht se iu ofrua mundësia, duke dhënë shpjegime të ndryshme. Disa pronarë mediash shprehën skepticizmin e tyre duke thënë që vetërregullimi i medias është, gjithsesi, një formë rregullimi dhe ata nuk mund ta pranonin atë. Të tjerë nuk donin t'i bashkoheshin një organizate në të cilën bënte pjesë edhe media lokale.

Patjetër që vetërregullimi i medias parapëlqehet kundrejt çdo forme tjetër rregullimi. Por vetërregullimi nuk do të ndodhë nëse ai nuk është një proces organik, të cilit i bashkohen të gjithë mediat në të gjithë vendin. Nga ana e përmbajtjes, ne theksojmë pikëpamjen tonë se shpifja duhet dekriminalizuar, pra duhet hequr nga Kodi Penal. Por njerëzit, që janë objekt i përbaltjes dhe shpifjes, duhet të kenë të drejtën të mbrohen. Nëse vetërregullimi i medias nuk ndihmon, kjo mbrojtje duhet të bëhet e mundur përmes mjeteve të së drejtës civile, jo përmes së drejtës penale. Dhe veprimet duhet të ndërmerren nga një gjykatë, jo nga një organ administrativ.

OSBE-ja është angazhuar për të bërë rekomandime edhe në këtë ligj. Në dijeninë tuaj, a janë reflektuar ato rekomandime në projektligj?

Jam shprehur qartë për këtë çështje edhe në dalje të tjera publike. Kjo është një pyetje shumë e mirë, por ndiej se duhet të bëj disa sqarime më parë. Shpesh, media në Shqipëri përdor etiketimin e përgjithshëm të OSBE-së, i cili përfshin shumë institucione dhe struktura, ndër të cilat misionet e saj, siç është Prezenca e OSBE-së në Shqipëri. Institucioni i OSBE-së, i cili punon me qeverinë e Shqipërisë për të përafuar legjislacionin e propozuar kundër shpifjes me standardet ndërkombëtare, quhet Zyra e Përfaqësuesit të OSBE-së për Lirinë e Medias. Ndodhet në Vjenë dhe monitoron lirinë e medias dhe lirinë e shprehjes në të gjithë zonën e OSBE-së, duke ofruar ndërkohë edhe mbështetje për promovimin e tyre. Prezenca e OSBE-së në Shqipëri nuk është pjesë e procesit të përmirësimit të këtij legjislacioni, ne vetëm monitorojmë dhe raportojmë.

Rekomandimet e Zyrës së Përfaqësuesit të OSBE-së për Lirinë e Medias janë publike dhe të disponueshme në internet, të vlefshme për muajin korrik 2019. Rekomandimet e tyre nuk u pasqyruan plotësisht në projektpaketën e ligjit kundër shpifjes, por qeveria vijoi të punojë me draftet që atëherë. Deklarata publike dhe rishikimet ligjore të bëra nga Përfaqësuesi i OSBE-së për Lirinë e Medias janë shumë të qarta dhe ato nënvizojnë saktësisht se çfarë është e pranueshme dhe çfarë jo. Ky institucion kryesor ndërkombëtar, pjesë e sistemit të OSBE-së, me siguri do të ketë një vlerësim të drafteve përfundimtare dhe do ta bëjë atë publik.

Fund